

Emri i Lëndës : Procedurë Penale							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 331	N/A	Vjeshtë	3.00	2.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Nertil Bërdufi, PhD					
Asistenti		Bledar Maksuti, LLM					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		E drejta procedurale penale është lënda mësimore që shpjegon, teorikisht dhe praktikisht legjislacionin procedural penal, institutet dhe dispozitat që rregullojnë procedimin penal në të gjitha fazat e tij. Ajo analizon shkencërisht sistemet procedurale penale, zhvillimin historik të legjislacionit procedural në Shqipëri deri në miratimin e Kodit të Ri të Procedurës Penale, si dhe parimet demokratike në të cilat bazohet procedimi penal. Analiza e percaktime të hollësishme bëhen për subjektet e procedimit penal, për vendin që zënë, rolin që luajnë dhe raportet midis tyre; për kuptimin, llojet dhe çmuarjen e provave; për kushtet dhe kriteret që duhen zbatuar në marrjen e masave të sigurimit; për detyrat e prokurorit dhe të policisë gjyqësore gjatë fazës së hetimeve paraprake; për rregullat e gjykimit në shkallë të parë; për kuptimin dhe veçoritë e gjykimit në apel dhe në kasacion; për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë; për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja etj. Programi është ndërtuar në përputhje me strukturën e Kodit të Procedurës Penale dhe për leksione të caktuara parashikon seminare teorikopraktik, në të cilat diskutohen përmbajtja e lëndës, lidhur me praktikën gjyqësore.					
Objektivat		Përgatitja e juristëve të ardhshëm me njohuri të thellë në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura për këtë qëllim, të aftë për dhënien e drejtësisë, në luftën kundër kriminalitetit, duke respektuar të drejtat e njeriut. Rritja e nivelit të formimit teorik të tyre nëpërmjet njohjes me të thelluar të mendimit të përparuar bashkëkohor për ndarjen e pushteteve, sistemet procedurale, parimet dhe institutet kryesore të procedimit penal etj. Konsolidimin e konceptit modern për pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe pozicionit kushtetues të prokurorisë. Kuptimin e drejtë të vendit që zene dhe rolin që luajnë subjektet e procedimit penal, raportet midis tyre, të drejtat dhe detyrimet që kanë dhe mënyra e realizimit të tyre në praktike. Formimit profesional e kulturor, të mbështetur në njohjen e legjislacionit dhe të praktikës gjyqësore, në etikën profesionale dhe kulturën e debatit. Fitimin e shprehive për mënyrën e hartimit të akteve procedurale, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullat gjuhësore e ato logjike, duke filluar nga marrja e kallëzimit, tek vendimi gjyqësorë i formës së prerë e deri tek vënia e tij në ekzekutim. Aftësimi për të proceduar konkretisht në hetimin paraprak dhe në gjykim, nëpërmjet diskutimit dhe zgjidhjes së rasteve të praktikës gjyqësore apo të gjyqeve gjithë të aktivizohen në role të caktuara. Stimulimi i punës së pavarur shkencore gjatë pjesës teorike ashtu dhe që do të zhvillohet gjatë semestrit.					
Konceptet Kryesore		1- Kodi i Procedurës Penale 2- Juridiksioni dhe kompetenca penale 3- Gjykimi në apel, 4- Gjykimi në Gjykatën e Lartë 5- Bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kuptimi dhe përmbajtja e së drejtës procedurale penale. Historiku i evolucionit të së drejtës procedurale penale. Sistemet procedurale dhe Kodi i Ri i Procedures Penale. Sistemi aktual procedural penal në Shqipëri						

2	Parimet kryesore të procedimit penal: parimi i ligjshmërisë; parimi i pavarësisë së gjyqates; parimi i prezumimit të pafajësisë; parimi i sigurisë së lirisë; parimi i sigurimit të mbrojtjes; parimi i ndalimit të gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale; parimi i rivendosjes së të drejtave; parimi i zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare
3	Subjektet e procedimit penal: Gjykata; Prokurori; Policia Gjyqësore; i Pandehuri; Mbrojtësi i të pandehurit; Viktima; Viktima akuzuese; Paditësi dhe i Padituri civil.
4	Juridiksioni. Kuptimi i juridiksionit penal dhe raportet e tij me juridiksionet e tjera. Kompetenca. Llojet e kompetencave. Mosmarrëveshjet për kompetencën. Bashkimi dhe ndarja e çështjeve.
5	Aktet kryesore të procedimit penal. Pavlefshmëria e akteve. Njoftimet, afatet për kryerjen e veprimeve procedurale. Organet dhe format e njoftimeve të akteve të procedimit penal.
6	Provat. Kuptimi i provës. Objekti i të provuarit. Procesi i të provuarit dhe fazat e tij. Llojet e provave. Mjetet e kërkimit të provës. Provat indirekte. Sigurimi i provës dhe çmuarja e provave.
7	Masat e sigurimit. Kuptimi i masave të sigurimit dhe funksionet e tyre. Masat e sigurimit personal Kohëzgjatja e masave të sigurimit. Revokimi zëvendësimi dhe shuarja e masave të sigurimit. Masat e sigurimit pasuror.
8	Provim Gjysmëfinal
9	Hetimet paraprake. Marrja dijeni për veprën penale. Kushtet e procedimit. Veprimtaria e subjekteve të procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake. Afatet e përfundimit të hetimeve paraprake.
10	Seanca paraprake. Kuptimi i seancës paraprake, veprimet përgatitore, verifikimi i paraqitjes së palëve. Zhvillimi i seancës. Vendimi për plotësimin e hetimeve; Kuptimi i ndryshimit të akuzës në seancë paraprake; Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake.
11	Gjykimi në shkallë të parë. Veprimet paraprake; Marrja e provave; Akuzat e reja; Vendimi i gjykatës.
12	Gjykimet e posaçme. Gjykimi i drejtpërdrejtë; Gjykimi i shkurtuar; Urdhëri penal i dënimit; Gjykimi me marrëveshje
13	Gjykimi mbi ankim. Objekti dhe subjektet e gjykimit në apel. Mënyrat e dispnomi. Rekursi në Gjykatën e Lartë. Shkaqet e rekursit. Paraqitja dhe shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë. Gjykimi në Kolegjet e Bashkuara
14	Rishikimi i vendimeve. Shkaqet e rishikimit të vendimeve. Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesës për rishikim.
15	Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja. Format e bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Islami, H., Hoxha, A., Panda, I. (2011). Procedura Penale . Tiranë: Morava	
Referenca të tjera	
• Vendime Unifikuese të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të R. SH (1999-2009) • Sahiti, E. Argumentimi në Procesin Penal • Hajdari, A. E Drejta Procedurale Penale	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të lëndës studenti do të jetë i aftë të fitojë njohuri të thellë në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura për këtë qëllim, të aftë për dhënien e drejtësisë, në luftën kundër kriminalitetit, duke respektuar të drejtat e njeriut
2	Studenti do të njohë vendin që zene dhe rolin që luajnë subjektet e procedimit penal, raportet midis tyre, të drejtat dhe detyrimet që kanë dhe mënyra e realizimit të tyre në praktike
3	Studenti do të jetë në gjendje të hartojë të akte procedurale ,në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullat gjuhësore e ato logjike, duke filluar nga marrja e kallëzimit, tek vendimi gjyqësorë i formës së prerë e deri tek vënia e tij në ekzekutim

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	5	80
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	12	12
Provimi final	1	16	16
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00